



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 50, datë 21.05.2024

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUNDI I RI, TË PASURISË ME NR.101/2, E LLOJIT TRUALL, ME SIPËRFAQE 1664 M², ME VENDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 3541

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 23, pika 13, nenit 54, nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Vendimit nr. 500, datë 14.08.2001 të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 15, datë 30.06.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, nenit 54 dhe 70, pika “c” të Ligjit nr. 10468, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në vijim të shkresave me nr. 2871/3 prot., datë 09.5.2024, dalë nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me lëndë për vijim e procedurave të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Durrës, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Katund i Ri, të pasurisë me nr. 101/2, e llojit truall, me sipërfaqe 1664m², me

vendodhje në zonën kadastrale 3541, për t'u përdorur në funksion të zbatimit të projektit "Qendër strehimi dhe trajtimi për kafshët", sipas formularit, gjithsej 1 (një) fletë dhe planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi i shtohet listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 431, datë 15.05.2013, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Katundi i Ri, të Qarkut të Durrësit".
3. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.05.2024



Lidhja 1

Bashkia Durrës, Njësia Administrative Katundi i Ri

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
—	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit	Në pronësi



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)



Identifikoi: **Fatjon Zeqiri** (Specialist) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Ervis Bahiti (Specialist) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
 Per Zyren e Pronave : Enli Kaculi (Specialist) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Anila Muhja (Specialist) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
 Supervizori: **Pranvera Gagani** (Pergj.Sek.Pronave) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Alneida Rroshi (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Alneida Rroshi Drejtorja Ligjore (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Emiriana Sako Kryetar i Bashkise (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Durres

Bashkia / Komuna :

Fusha e perdorimit te Prones: Prona qe perdoren ne fushen e bujqesise dhe ushqimit

Nr. Rend.	A			B		C			Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)	
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale. Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me perqeljesi administrative		Institucioni / Enti perdonues Statusi juridik i perdorimit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	3541 K-34-88-(209-D)	101/2	Truall	Qender strehimi dhe trajtimi per kafshet Bashkia Durres	1664 m2		Per sterilizimin dhe dezinfektimin e kafsheve	Bashkia Durres	Bashkia Durres	



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI SHETET

DATE 10/05/2024

QELIMI PER TRANSFERIMI

VENDNDODHJA

BASHKIA DURRES DVASHK DURRES ZONA KADASTRALE 3541 NUMRI I PASURISE 101/2 INDEKSI I HARTES K-34-88-(209-D)


TË DHËNAT E PASURISË

LLOJI I PASURISË: TRUALL SIPERFAQA E PASURISË = 1664 m2 ZONA KADASTRALE 3541 NUMRI I KATEVE NUMRI I PEMEVE

X 459698.1345
Y 4583495.0713

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 460387.5204
Y 4583495.0713



X 459698.1345
Y 4583072.2719

SH 1:2500

X 460387.5204
Y 4583072.2715

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	V-			291		
2	L-			297		
3	J-			101/3		
....	P-			101/1		

REALIZOI PER BASHKINE DURRES

PUNOJ: **FATJON ZEQIRI** ENLI KACUL
ERVIS BAHITI ANILA MUJA

NENSHKRIMI: *[Signature]*

PERQJEGJES: **PRAMVERA GAGANI**

NENSHKRIMI: *[Signature]*

DREJTORI: **ALNEIDA RROSHI**

NENSHKRIMI: *[Signature]*

KRYETAR: **EMIRIANA SAKO**

NENSHKRIMI/VULA: *[Signature]*

REALIZOI PER DVASHK

SPECIALISTI: **GERALO KACI**

NENSHKRIMI: *[Signature]*

KONFIRMOI

PERQJEGJES/DREJTORI: _____

NENSHKRIMI/VULA: _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Datacish;

PERCAKTIMI KUFIRIT: _____

Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; L-Kufitarët të Parshtetë;
PB-Përfaqesues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIMAS TE VECANTA:



PRONARI/BASHKIA PRONARET-DEKLARIMI MBI MARREDMENIET ME KURTYARET

EMRI: _____

NENSHKRIMI: _____





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 328/prot.

Durrës, më 29.05.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës**

19.05.24 5972/3

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.50 datë 21.05.2024 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, Për Njësinë Administrative Katund i Ri, të pasurisë me nr.101/2, e llojit truall, me sipërfaqe 1664 m2, me vendodhje në zonën kadastrale 3541”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

